



Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës
Kosovo Women's Chamber of Commerce
Privredna Komora Žena Kosova

Raporti Vjetor 2023

Maj, 2023
Prishtinë

Sfondi

Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës-G7 është organizate e pavarur, jopolitike, vullnetare dhe jofitimprurëse në shërbim të fuqizimit të gruas në ekonominë Kosovare. Partner konstruktiv i institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, partner në dialogun social si dhe promotor i zhvillimit ekonomik dhe politikave të mira me pjesëmarrjen aktive të gruas.

Misioni:

Në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të lehtësojë, llojë dhe promovojë përfaqësimin e grave në ekonomi, në politikë dhe vendimmarrje.

Vizioni:

G7 e sheh gruan si promotor të ekonomisë së Kosovës. Pjesëmarrjen e gruas në të gjitha vendimmarrjet që nga niveli lokal e deri te ai kombëtar. Përfshirjen e saj në mënyrë të barabartë në ekonomi, politike dhe të gjitha sferat e tjera të politikave zhvillimore të vendit.

Objektivat kryesore:

- Promovimi dhe zhvillimi i aftësive dhe arritjeve të grave afariste;
- Mbrojtja e integritetit afarist dhe veçoritë individuale të gruas afariste;
- Përfshirja e principeve të sigurimit të barazisë gjinore dhe te drejtës ligjore në punë;
- Unifikimi i qëndrimeve të grave afariste dhe grave në ekonomi në përgjithësi dhe prezantimi i përbashkët karshi Parlamentit, Qeverisë, Organizatave profesionale dhe organizatave tjera me interes;
- Krijimi i komunikimit të ndërsjellët në mes grave afariste dhe grave në ekonomi në tërë territorin e Kosovës si dhe komunikimi me gratë e biznesit në botë;
- Informimi i rregullt i grave ne ekonomi për aktualitetet qe janë në interes të zhvillimit ekonomik të vendit;
- Ndërtimi i një kulture afariste e bazuar në dije, aftësi dhe etikë profesionale;
- Një zhvillim i përgjithshëm ekonomik përmes angazhimit të potencialeve të vërteta të gruas në ekonomi;

Tabela e përmbajtjes

▪ Përmbledhje Ekzekutive	4
▪ Aktivitetet kryesore dhe të arriturat gjatë vitit	6
▪ Të hyrat dhe shpenzimet	20
▪ Anëtarët e G7	23

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Aktivitetet kryesore të Dhomës Ekonomike të Grave të Kosovës – G7 janë fokusuar kryesisht në realizimin e objektivit të parë gjegjësisht në avokim dhe lobim për zhvillimin e një ambienti më të favorshëm e të bërit biznes me pjesëmarrje sa më të madhe të grave. Po ashtu në objektivin e dytë dhe të tretë në ngritjen e kapaciteteve të grave ndërmarrëse si dhe në aktivitete rrjetëzuese dhe promovuese brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë këtij viti janë zhvilluar këto aktivitete: organizimi i Konferencës Rajonale për Gratë Ndërmarrëse dhe Takimet B2B, lansimi i Platformës Gjithëpërfshirëse për Gratë Ndërmarrëse, takim rrjetizues ndërmjetë grave ndërmarrëse dhe promovimi i bizneseve të reja, trajnim për Menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

G7 ka incuar themelimin e Dhomës Rajonale për Gratë Ndërmarrëse, me këtë rast ka nënshkuar Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të Dhomës Ekonomike të Gruas të Shqipërisë WECA, Shpqrata për Gratë në Biznes të Maqedonisë së Veriut dhe Shoqrata për Gratë Ndërmarrëse të Malit të Zi.

G7 ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me CDF dhe Programin e USAID IEE Aktiviteti Gjithëpërfshirës Ekonomik, për program të përbashkët një vjeçar për fuqizimin e ndërmarrësisë së grave dhe themelimin e Platformës Gjithëpërfshirëse për Ndërmarrësinë e Grave.

G7 ka marrë pjesë në Konferencën Rajonale të Grave në Biznes ‘Ndërtojmë ura bashkëpunimi’ në Tiranë, organizuar nga Dhoma Ekonomike e Gruas në Shqipëri; Konferenca Ndërkombëtare ‘Unstoppable’ organizuar nga Western Balkans Fund në Tiranë; Samiti i Diasporës Shqiptare (edicioni i tretë), organizuar nga Dhoma e Diasporës Shqiptare në Tiranë; Samiti Vjetor i Platformës Kombëtare për Gratë Sipërmarrëse ‘Inspirin the future’ organizuar nga Shoqrata e Grave Ndërmarrëse të Maqedonisë.

Po ashtu ka marrë pjesë në takimin e parë të Këshillit Konsultativ Publiko-Privat të Komunës së Prishtinës, dhe ka kontribuar në përgaditjen e rekomandimeve të sektorit privat për sektorë relevante.

G7 e përfaqësuar me bizneset antare ka marrë pjesë në panairin ndërkombëtar në fushën e mobiljerisë në Inegol të Turqisë.

Duke konsideruar shumë të rëndësishëm promovimin e suksesit të grave si në ekonomi e po ashtu dhe në çdo fushë tjetër të zhvillimit të shoqërisë, jo vetëm për të ndryshuar perceptimet, por edhe për të ngritur ndërgjegjësimin në lidhje me angazhimin e gruas në aspektin ekonomik, politik dhe shoqëror si pjesë e barabartë të shoqërisë. G7 në bashkëpunim me RTV 21 kanë vazhduar me projektin e përbashkët Emisioni **START UP** që ju dedikohet ndërmarrësisë së grave. Gjatë këtij viti kanë realizuar 43 emisione përmes së cilës janë trajtuar tema të ndryshme.

Më 08 maj 2023, Shkup

Marrëveshje për Bashkëpunim Reciprok për Fuqizimin Ekonomik të Grave të Vendeve të Ballkanit Perëndimor

Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës -G7 së bashku me Dhomën Ekonomike të Grave të Shqipërisë - WECA, Shoqata e Grave Afariste - ABW (Association of Business Women - Macedonia), Shoqata e Grave Afariste të Mali i Zi-BWA (Asocijacija poslovnih zena Crne Gore/Business Women Association Montenegro), nënshkruan Marrëveshje për Bashkëpunim Reciprok për Fuqizimin Ekonomik të Grave në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Kjo marrëveshje synon të krijojë një platformë për promovimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit efektiv në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, ndërmarrësinë e grave, aktivitetet tregtare dhe investuese ndërmjet këtyre vendeve. Bashkëpunimi i ndërsjellë ekonomik është vendimtar për të garantuar zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të reja punës, prosperitetin dhe paqen në rajon.



Më 14 qershor 2023, Prishtinë

Lansimi i Platformës Gjithëpërfshirëse për Ndërmarrësinë e Grave

Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës-G7 në bashkëpunim me USAID Programi IEEA Aktiviteti i Zhvillimit Gjithëpërfshirës Ekonomik i zbatuar nga Fondi për Zhvillimin Komunitar CDF (Community Development Fund) nënshkruan Marrëveshje Bashkëpunimi për periudhën 2023-2024.

Me këtë rast u lansua Platformën Gjithëpërfshirëse për Ndërmarrësinë e Grave -IPWE (Inclusive Platform for Women Economic Empowerment) për fuqizimin ekonomik të grave. IPWE është një iniciativë për mbështetjen dhe fuqizimin e grave ndërmarrëse dhe bizneseve të udhëhequra nga gratë e të gjitha komunitetet etnike në Kosovë. Platforma synon të krijojë një ekosistem mbështetës për gratë ndërmarrëse në Kosovë, përmes zhvillimit të një mjedisi më të qëndrueshëm e të bërë biznes, aftësimin profesional, ngritje kapacitetesh, rrjetizim, shkëmbim përvojash dhe qasje në burime që do t'i ndihmojnë dhe rrisin bizneset e tyre.





Më 22.07.2023, Prishtinë
Takimi Rrjetizues ndërmjetë Grave
Ndërmarrëse

Në kuadër të IPWE 'Platforma Gjithëpërfshirëse për Ndërmarrësinë e Grave' u organizua Takimi Rrjetizues ndërmjetë Gratë Ndërmarrëse në Prishtinë. Kjo ngjarje kishte për qëllim ndërlidhjen e bizneseve të udhëhequra nga gratë të sektorëve të ndryshëm, rritjes së vizibilitetit si dhe promovimit të produkteve dhe shërbimeve të tyre.



Panelistet diskutuan rreth të arriturave të bizneseve të tyre, si dhe rreth produkteve të cilat ato ofrojnë nga katër biznese të reja si storie suksesi. Në panel diskutimi morën pjesë Erblina Avdijaj, kompania Bliff Organik (prodhim të çajrave); znj. Slavica Gjokic nga kompania Red Diamond (prodhim të frutave pyjore, alkoholit dhe mjaltës); znj. Aferdita Natural Berry (prodhimi i frutave pyjore si dhe lëngjeve).

Takimi ofroj mundësi të mirë për shkëmbim të ideve dhe përvojave, zgjerim të rrjetit të kontakteve si dhe shtrirjes së bashkëpunimeve të reja ndërmjet bizneseve. Po ashtu ofroj mundësi të promovimit të produkteve të grave, rrjetizimit, dhe shkëmbimit të informatave ndërmjetë grave ndërmarrëse.



Më 11.09.20203, Prishtinë

Lansimi i linkut: Regjistrimi i Bizneseve në IPWE-Platforma Gjithëpërfshirëse për Ndërmarrësinë e Grave

Në kuadër të Platformës Gjithëpërfshirëse të Ndërmarrësisë së Grave, G7 lancoj linkun për regjistrimin e bizneseve në pronësi të bizneseve

<https://docs.google.com/.../1QNuyryPMVDBmWAPlxJMfrsS.../edit>.

Platforma Gjithëpërfshirëse për Ndërmarrësinë e Grave (IPWE) është zhvilluar për të mbështetur gratë ndërmarrëse duke ofruar një platformë për regjistrim të biznesit, informimit dhe rrjetëzimit. Qëllimi i IPWE është të ofrojë akses në burime si mundësi financimi, trajnime dhe mentorim, dhe të lehtësojë lidhjet midis grave ndërmarrëse. Duke vepruar kështu, IPWE synon të nxisë një mjedis gjithëpërfshirës që promovon rritjen dhe suksesin e bizneseve në pronësi të grave, duke kontribuar në fuqizimin ekonomik dhe barazinë gjinore në sipërmarrje.

Më 16.11.2023, Prishtinë

Konferenca Rajonale dhe Takimet B2B me temën “Fuqizimi i grave ndërmarrëse: Ndërtimi i urave, thyerja e barrierave”.

Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës-G7 në bashkëpunim me USAID, Ambasadën Holandeze në Prishtinë, Bankën TEB SH. A, organizojë Konferencën Rajonale dhe Takimet B2B me temën ‘Fuqizimi i grave ndërmarrëse: Ndërtimi i urave, thyerja e barrierave’.

Qëllimi i Konferencës ishte promovimi dhe nxitja e bashkëpunimit ekonomik rajonal, tregtisë, inovacionit dhe konkurrueshmërisë në mes të bizneseve të grave në rajon. Konferenca shënojë një moment të rëndësishëm në nxitjen dhe rritjen e bashkëpunimit të ndërmarrësisë së grave.



Në këtë ngjarje morën pjesë rreth 210 biznese nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe diaspora. Kjo ngjarje ofroj mundësi rrjetëzimi, informimi, shkëmbimi të njohurive dhe përvojave, mundësi të zgjerimit të bashkëpunimeve të reja duke nxitur një ekosistem mbështetës për gratë në biznes. Në një ambient dinamik dhe frymëzues 210 gratë ndërmarrëse, pronare dhe drejtuese të bizneseve nga vendi, rajoni dhe diaspora zhvilluan edhe takime B2B nërmjetë tyre.

Ngjarja u hap me fjalimet kryesore nga znj. Afërdita Kelmendi, Presidetja e G7, znj. Eileen Devitt, Shefja e Misionit të USAID në Kosovë, z. Ronald Goldberg, Zëvendës Ambasadori i Mbretësisë së Holandëz, z. Serhan Ozarslan, Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Bankës TEB Sh.A.

Znj. Kelmedi, theksojë arritjet dhe kontributin e G7 në fuqizimin ekonomik të grave dhe themelimin e Dhomës Ekonomike Rajonale të Grave Ndërmarrëse, si hap i rëndësishëm për të promovuar bashkëpunimin tregtar dhe investimet rajonale dhe për të kontribuar në rritjen ekonomike në rajon.

Znj. Eileen Devitt, Drejtoreshë e Misionit të USAID-it, nderoi ngjarjen, duke theksuar rëndësinë e fuqizimit të grave në fushën e biznesit. “Gratë sipërmarrëse luajnë një rol vendimtar në nxitjen e rritjes ekonomike dhe nxitjen e inovacionit, si në nivel lokal ashtu edhe në një shkallë globale”, theksoj ajo.



Folësit theksuan rëndësinë e fuqizimit ekonomik të grave si ndryshimi nxitës në shoqëri dhe rritjen ekonomike. Mbështetja dhe kontributi i organizatës drejt fuqizimit ekonomik të grave dhe tejkalimit të barrierave, si aksesimi në financa, rrjeti dhe aksesimi në tregje të reja.



Konferenca paraqiti dy panel diskutime me gra ndërmarrëse nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria. Këto diskutime u përqëndruan në temat kryesore të bashkëpunimit rajonal, aksesit në financa dhe drejtësisë tregtare. Perspektivat e ndryshme të përbashkëta diskutuan sfidat dhe mundësitë që mbizotërojnë në ekosistemin sipërmarrës të rajonit.

Paneli i parë | Dhomat Ekonomike të Rajonit: Përsheptimi i rimëkëmbjes ekonomike, transformimit dhe qëndrueshmërisë në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor.

Diskutojë rreth qëllimit dhe benefiteve të Marrëveshjes për Bashkëpunim Reciprok për Fuqizimin Ekonomik të Grave Nënndërmarrëse në vendet e Ballkanit Perëndimor të nënshkruar me 8 maj 2024 në Shkup. Sektorëve potencial për bashkëpunim dhe zhvillim rajonal në mes të bizneseve të grave, arritjeve të biznesve në pronësi të grave si dhe pengesat për bashkëpunim ndërkufitar.

Panelistët: znj. Linda Shala, G7; znj. Elena Zdruzenie Blazevska, Association of Businesswomen Macedonia; znj. Antonela Hako, WEECA; Ms. Sara Liesker, Women Business Association of Netherlands; znj. Elisabeta Katiaj, Oda Ekonomike e Diasporës Shipëtare.



Paneli i dytë | Gratë Sipërmarrëse si shtytëse kryesore të rritjes ekonomike Promovimi i një ekosistemi të lulëzuar për gratë sipërmarrëse

Në këtë panel, diskutimet mbuluan tema të ndryshme kyçe duke përfshirë reformat në Gjykatën Tregtare dhe përfitimet e tyre për bizneset, avantazhet e marrëveshjeve të arbitrazhit dhe tendencat aktuale në teknologji dhe inovacion. Paneli theksoi gjithashtu përdorimin e teknologjisë dhe inovacionit për suksesin e biznesit, duke shfaqur histori suksesi dhe praktikata më të mira nga gratë që kanë shkëlqyer në TIK dhe inovacion. Përveç kësaj, paneli eksploroj potencialin e eksportit, duke u fokusuar në thyerjen e barrierave dhe shfrytëzimin e mundësive për gratë sipërmarrëse, me histori suksesi dhe praktika më të mira nga gratë që kanë shkëlqyer në eksport.

Panelistët: z. Blendi Hasaj, GAP; znj. Shkendije Himaj, USAID; znj. Antoneta Ndreka, Lufra; znj. Suzana Naumoska, Izida; znj. Luljeta Plakolli-Kasumi, Arbiter; znj. Saranda Bogaj, Gjykata Komerciale, znj. Vesa Morina, Zeta Corporation.



Për më tepër, ngjarja mundësoi rreth 400 takime B2B midis bizneseve rajonale. Këto takime shërbyen si platforma për krijimin e partneriteteve, eksplorimin e tregjeve të reja dhe nxitjen e bashkëpunimeve që tejkalojnë kufijtë. Angazhimi gjatë këtyre takimeve nxori në pah dëshirën e sipërmarrësve për të zgjeruar rrjetet e tyre dhe për të eksploruar territore të reja.

Konferenca dhe takimet B2B demonstuan fuqinë e bashkëpunimit dhe dialogut në nxitjen e suksesit sipërmarrës. Duke bashkuar pjesëmarrës nga rajone të ndryshme dhe duke nxitur diskutime mbi aspektet thelbësore të biznesit, ngjarja hapi rrugën për bashkëpunim të zgjeruar, rritje dhe mundësi për gratë sipërmarrëse përtej kufijve.

Gratë sipërmarrëse luajnë një rol vendimtar në nxitjen e rritjes ekonomike dhe nxitjen e inovacionit, si në nivel lokal ashtu edhe në një shkallë globale.





Kjo ngjarje u sponsorizua nga Albi Mall, Hotel Emerlad, Procredit Bank, TEB Bank Sh.A, Banka Ekonomike.

AKTIVITETE MBI NGRITJEN E KAPACITEVE TË GRAVE NDËRMARRËSE

Më 25 maj 2023, Prishtinë

Trajnim për gratë ndermarrëse: MENAXHIMI I SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

Rreth 20 gra sipërmarrëse morën pjesë në trajnimin për parandalimin e ngacimit seksual në vendin e punës dhe tani janë në gjendje dhe të aftë të zhvillojnë politika parandaluese dhe raportuese që do të zbatohen në kompanitë e tyre. U diskutuan koncepte teorike për të kuptuar më mirë llojet e ngacmimeve seksuale në vendin e punës në kontekstin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe Punës së Denjë, të ndjekura nga skenarë të ndryshëm të ngacimit seksual për ta identifikuar më mirë atë dhe çfarë masash duhet të ndërmerren.

Ky trajnim u organizua nga UN Women Kosova në partneritet të ngushtë me Dhomën Ekonomike të Grave të Kosovës - G7 në kuadër të projektit "Komponenti gjinor në promovimin e punës së denjë përmes

menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë”, nën menaxhim. dhe marrëveshje me Organizatën Ndërkombëtare të Punës dhe financiar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë.



PJESËMARRJA NË KONFERENCA DHE TRYEZA DISKUTIMI

Më 20-23 shkurt 2023, Tiranë

G7 mori pjesë në Konferencën ndërkombëtare “Unstoppable” (E pandalshme) organizuar nga Western Balkans Fund, për të promovuar barazinë gjinore në të gjitha nivelet e qeverive, sektorit privat dhe agjencive joqeveritare.

Për katër ditë, nga 20-23 shkurt 2023, Konferenca trajtoi një sërë temash në të gjithë spektrin e të drejtave të njeriut, duke rritur njohuritë dhe duke forcuar rrjetin e profesionistëve që vijnë nga rajonet WB6, V4, Japonia, Zvicra dhe vendet e BE-së.

Gjatë shumë sesioneve dhe ngjarjeve të lidhura me to, pjesëmarrësitë ishim në gjendje të zbulonim aftësitë e duhura në trajtimin e çdo forme diskriminimi dhe të jepnim një mesazh më të bazuar dhe fuqizues në lidhje me përkthimin e shkencës ndërsektoriale të udhëheqjes në veprime të qëndrueshme. Me pjesëmarrjen e më shumë se 60 folësve të zgjedhur dhe më shumë se 150 pjesëmarrësve të dalluar nga 20 vende, Konferenca Unstoppable (E Pandalshme) është bërë tashmë një nga Konferencat Rajonale më të mëdha të vitit 2023.



Më 13 mars 2023, Prishtinë

Tryezë e Grupit të Grave Deputete: Promovimi i lejes së lehonisë në Kosovë

Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës-G7 e përfaqësuar nga Zëvendës Presidentja, znj. Linda Shala, mori pjesë sot në tryezën e organizuar nga Grupi i Grave Deputete, në bashkëpunim me Fondin për

Popullsi të Kombeve të Bashkuara (UNFPA), lidhur me politikat e përgjegjshme gjinore për familjen në Kosovë.

Tema e diskutimit “Promovimi i lejes së lehonisë në Kosovë: Strategjitë për ndryshim - Përfshirja e dispozitave për Balancin Punë-Jetë”, me ç’rast u diskutuan rekomandimet e zhvilluara për lejen prindërore dhe lejen e lehonisë. Tryeza u përcoll me diskutime të frytshme nga pjesëmarrësit, të cilët elaboruan sfidat që lidhen me mungesën e një kornize ligjore gjithëpërfshirës që rregullon pushimin e lehonisë, si dhe mundësinë e identifikimit të zgjidhjeve të mundshme për të përmirësuar zbatimin e politikave të pushimit të lehonisë në Kosovë.



Më 19 mars, 2023 Tiranë

**Takimi rrjetizues ndërmjetë grave ndërmarrëse të Ballkanit
Albanian Excellence**

Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës e përfaqësuar nga zëvendës Presidentja Linda Shala u prezantua në takimin e grave shqiptare të profileve të ndryshme Albanian Excellence. Ky event ofroj një mundës të mirë për të shkëmbyer përvojat dhe njohur ndërmjetë grave ndërmarrëse nga vendet e Ballkanit.



Më 30 mars 2023, Tiranë

Konferenca ‘Forcojmë Urat e Bashkëpunimit me Grave Ndërmarrëse të Rajonit’

Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës të përfaqësuar nga Presidentja Afërdita Saraqini Kelmendi, zëvendës Presidentja Linda Shala morën pjesë në panel diskutimi të kësaj konference. Znj. Kelmendi propozoi themelimin e Dhomës Rajonale për Gratë Ndërmarrëse përmes së cilës do të avokohej për politika të mirëfillta të cilat ndikojnë në një të ardhme më të mirë, forcimin e marrëdhënieve, krijimin e network-ut mes grave dhe vajzave sipërmarrëse dhe drejtuese në rajonin tonë, zgjerimin e tregut, shkëmbimim e praktikave dhe eksperiencave më të mira, nisja e partneriteteve dhe bashkëpunimeve mes njëra tjetrës dhe shkëmbimi i informacionit.

Ky event bëri bashkë përfaqësues të biznesit, gra sipërmarrëse dhe drejtuese nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia Perëndimore, Mali i Zi, shoqëria civile, ambasada etj. Qëllimi i këtij eventi ishte diskutimi dhe parashtrimi i sfidave dhe gjetja e mundësive për zgjidhje, nxitja e bashkëpunimit, zhvillimi dhe propozimi i iniciativave të përbashkëta, rekomandime për politika të mira miqësore për gratë, nxitja e rolit të tyre për zgjidhjen e çështjeve të përfaqësimit në nivel lokal, por edhe për bashkëpunimin dhe bashkëveprimin rajonal.



Më 14 nëntor 2023, Prishtinë

Trakim me Kryetarin e Komunës së Prishtinës: Themelimi i Këshillit Publiko-Privat të Bizneseve të kryeqytetit

Komuna e Prishtinës themelojë Këshilli Publiko-Privat të Bizneseve të kryeqytetit, i cili do tju ndihmojë bizneseve komunikim të drejtëpërdrejtë me nivelin e lartë të qeverisjes së Komunës së Prishtinës. G7 morei pjesë në takimin e parë p]rfaqësuar nga zëvendës Presidentja e Bordit dhe gjashtë biznese antare.

Në Këshillin Publiko - Privat të Bizneseve të kryeqytetit përbëhet nga një numër i madh i kompanive e institucioneve tjera ekonomike private të cilat operojnë në Prishtinë dhe Kryetarin e nënkryetarëve të Kryeqytetit. Ky organ do të ju ndihmojë bizneseve në krijimin e një kanali komunikues mes tyre dhe nivelit të lartë qeverisës të Kryeqytetit Prishtina.

Bizneset përmes këtij Këshilli tani e tutje mund të shprehin shqetësimet e kërkesat e tyre në lidhje me çështjet pronësore, tatimit dhe fushave tjera, të cilat do të trajtohen nga Kryeqyteti.

Ky takim me bizneset është mundësuar përmes projektit të USAID për të drejtat pronësore.



Më 25.11.2023, Prishtinë **Diaspora Shqiptare për Zhvillim të Qëndrueshëm**

Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës - G7 mori pjesë në Panelin 'Diaspora Shqiptare për Zhvillimin e Qëndrueshëm', organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, në kuadër të Samiti i Diasporës edicioni i tretë.

Forumi u hap nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë z.Ervin Mete dhe Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Klimës së Biznesit, znj.Delina Ibrahimaj. Samiti i Diasporës, është forumi më i madh i kthyer tashmë në traditë, gjatë së cilës prezantohen ide edhe politikat shtetërore për të nxitur përfshirjen e shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve në zhvillimet e brendshme të vendit.

Forumi ofron mundësi shumë të mira për të thelluar më tej komunikimin dhe bashkëpunimin me qëllim përfshirjen sa më të gjerë të Diasporës në zhvillimin ekonomik si dhe në ndërlidhjen e tregjeve të rajonit me tregjet e Bashkimit Europian. Po ashtu ofron mundësi të mirë për përfshirjen e energjive, kapaciteteve njerëzore dhe financiare, por edhe të njohurive të Diasporës shqiptare në këtë drejtim.



Më 25 nëntor, Shkup **Ndërmarrësia e Grave, Samiti 2023 'Key to Strengthening the Economy'**

Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës mori pjesë në Samitin Vjetor të Platformës Kombëtare për Gratë Ndërmarrëse 'Key to Strengthening the Economy' organizuar nga Shoqata e Grave në Biznes të Maqedonisë (Association of Business Women - Macedonia).

Në panelin 'Gratë e fuqizuara në ndërmarrësi përmes shoqatave ndërkombëtare' mori pjesë znj. Afërdita Kelmendi, Presidente e G7 së bashku me përfaqësueset e organizatave të tjera si: znj. Antonela Hako, Kryetare e Dhomës Ekonomike të Gruas të Shqipërisë, znj. Vesna Milovanović, Rrjeti i Zhvillimit Rural Serbi, znj. Mariam Chikopaidze, Presidente e Shoqatës së Grave Sipërmarrëse AWE Georgia, znj. Sofia Šmitran, Komisionere Rajonale për Vendet e Ballkanit në Shoqatën Botërore të Grave Sipërmarrëse FCEM, Kroaci, znj. Valentina Disoska Znj.Emilija Andonova Fondacioni për Menaxhment dhe Hulumtim Industrial Shoqata e Grave Afariste - Maqedoni Odat Ekonomike të Maqedonisë



Më 01-04 maj, Inegol Panairi Ndërkombëtar MODEF 2023

Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës-G7 mori pjesë në panairin ndërkombëtar të dizajnit dhe mobiljerisë 'MODEF 2023' e cila u organizua në Inegol-it të Turqisë. Në këtë panair mbi 200 kompani vendore ekspozuan produkte me të reja të mobilerisë, dekoreve dhe interierit të brendshëm, ndërkaq nga Kosova ishin të pranishëm rreth 50 biznese.



PROMOVIMI I BIZNESEVE TË GRAVE

RTV 21 Emissioni START UP

Gjatë vitit 2023 ka vazhduar bashkëpunimi në mes të G7 dhe RTV 21 për realizimin e emisionit START UP në RTV 21. Përmes këtyre emisioneve janë trajtuar tema të ndryshme për zhvillim ekonomik të vendit sipas sektorëve, si dhe zhvillimi i ndërmarrësisë së grave në vend. Gjithësejtë janë realizuar 43 emisione.



Më 01 maj 2023, Tiranë KLAN TV, Emissioni Opinion

Emisioni diskutojë për rrugëtimin e grave të suksesëshme në zhvillimin e bizneseve të tyre. G7 u përfaqësua kompaninë Hummë të znj. Arbërore Riza.



Më 16 maj 2023, Prishtinë
KLAN Kosova, Emisioni Rubikon

Emisioni trajtoj temat për zhvillimin ekonomik, mundësitë për punësim dhe ndërmarrësi në Kosovë, bashkëpunimi ekonomik i Kosovës me shtetet e rajonit dhe përparësitë e vendeve të punës në Kosovë.

G7 u përfaqësua me zëvendës Presidenten Linda Shala, panelistët e tjerë ishin: Arian Zeka, Leonora Kusari, dhe Lulzim Rafuna.



